


“Rehabilitimi i Emergjences Civile-Murmbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”

# Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

(VNM Paraprake)



**Objekti: “Rehabilitimi i Emergjences Civile-Murmbajtes me tel gabion në Rrugën “Kol Kamsi”.**

*Adresa: Rruga “Kol Kamsi”, Njësia Administrative nr. 2, Sauk, Tiranë*

Raporti i vnm-së është hartuar dhe punuar në përputhje me VKM nr. 686 datë 27.09.2015, për miratimin e rregullave dhe përgjegjësi të afatshme për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis. Si dhe janë mbajtur në koherencë të plote gjithë Ligjet dhe VKM përkatëse për mjedisin në mënyrë që investitori të marrë parasysh gjatë procesit të zhvillimit të projektit për të pasur sa më pak efekte anësore në mjedis.

*Sipas Shtojcës II, të ligjit nr.10440, datë 7.7.2011, pika 10.b) “Projekte për zhvillime urbane”.*

**HARTOI : ETTA CONS sh.p.k**

Ing.Dhimiter Pina

Tel: 0692063687

e-mail: [ettacons22@gmail.com](mailto:ettacons22@gmail.com)



Permbajtja sipas pikës 1.2 f të VKM Nr. 686, datë 29.7.2015.

“Rehabilitimi i Emergjences Civile-Murmbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”

### **Hyrje**

**Informacion per qellimin e VNM dhe metodika e zbatuar.**

*-Pershkrimi i qellimit dhe objektivat e VNM*

*-Pershkrimi i permbledhur i kuadrit ligjore mjedisor edhe instutucional qe lidhen me projektin*

*-Pershkrim te metodikes te zbatuar per hartimin e raportit paraprak te VNM –se*

**a)Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;**

**b) Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;**

**c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;**

**ç ) Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;**

**d) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;**

**dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;**

**e) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;**

**ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;**

**f) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).**

### **Hyrje**

**Informacion per qellimin e VNM dhe metodika e zbatuar.**

“Rehabilitimi i Emergjences Civile-Murmbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”

*-Pershkrimi i qellimit dhe objektivat e VNM*

*-Pershkrimi i permbledhur i kuadrit ligjore mjedisor edhe instutucional qe lidhen me projektin*

*-Pershkrim te metodikes te zbatuar per hartimin e raportit paraprak te VNM –se*

Objektivat e VNM-se konsistojne ne analizimin e faktoreve lokale e negative mjedisore, ne dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative, si dhe ne permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit per projektin “Rehabilitimi i Emergjences Civile-Murmbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”.

Qellimi i VNM eshte, qe nepermjet vleresimit cilesor e sasior paraprak te parametrave mjedisore.

Ky raport ka per qellim te sherbeje:

- Si instrument per mbrojtjen e mjedisit;
- Ne fuqizimin e komunitetit per veprime ne mbrojtje te mjedisit;
- Ne kontrollin e perdorimit te qendrueshem te burimeve natyrore;
- Ne rritjen e mireqenies nga menaxhimi afatgjate i burimeve ujore;
- Ne mbrotje te pasojave financiare dhe social-ekonomike;
- Ne rritje te interesimit per bashkepunim dhe ne gjetjen e zgjidhjeve te reja, etj

***Pershkrimi i permbledhur i kuadrit ligjore mjedisor edhe instutucional qe lidhen me projektin.***

Aplikimet per VNM kane si detyrim paketen ligjore te meposhtme:

- Ligji Nr. 10431, dt 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”,
- Ligji nr 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”,
- Ligji nr 10448, datë 17.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”,
- Ligji nr 9774, datë 12.07.2007 “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”,
- Ligji 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”,
- Ligji nr 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin e zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”,
- Ligji nr 8906, date 6.6.2002 « Për Zonat e Mbrojtura”,
- Ligji nr 8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.
- Ligji nr 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”,
- VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”,
- VKM nr 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”,
- VKM nr 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”,

## “Rehabilitimi i Emergjences Civile-Murmbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”

- VKM nr 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”,
- VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”,
- VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji Nr. 9010 dt. 13.03.2003 “Per Administrimin Mjedisor te Mbetjeve te Ngurta”,
- Ligji aktualisht në fuqi nr. 162/2014, i ndryshuar “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i cili shoqërohet me disa akte nënligjore në zbatim të tij.
- Ligji aktual në fuqi nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.
- Ligji në fuqi nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”.
- Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”.

### a)Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;

Qëllimi i projektit është rehabilitimi i emergjences civile-murmbajtese me tel gabion ne rrugen “Kol Kamsi”. Muri mbajtes me gabion do te ndertohet poshte disa shtepive private te banimit ne rrugen Kole Kamsi, poshte varrezave te deshmoreve ne rrugen e Elbasanit ne Bashkine Tirane. Terreni ku ndodhen keto shtepi eshte shume i pjerret dhe me karakteristika gjeologjore inxhinierike te dobta. Si rrjedhoje edhe disa mure te vjeter mbajtes prej betoni te ndertuar nga banoret ne menyre individuale jane shkaterruar. Per pasoje, kjo zone eshte nje vend me rrisht te larte qe mund te sjelle pasoja katastrofike deri ne prishjen e shtepive nga rreshqitjet e terrenit.



## “Rehabilitimi i Emergjences Civile-Murbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”

**Bimësia** ne zonen ku do te zhvillohet projekti eshte e pasur me nje bimesi ku mbizotrojne llojet mesdhetare te bimesise si: mareja, shqopa, ilqja, etj., kurse ne brendesi te tyre, bimet si dushku, ahu, bredhi, pisha e zeze etj. Gjithashtu jane te shumta bimet endemike, pra bimet qe riten vetem ne vendin tone. Per shkak te mbizotimit te relievit kryesisht kodrinoro-malor, qe kushtezon ndryshime te dukshme te klimes dhe te faktoreve te tjere, bimesia eshte e shkallezuar ne drejtimin vertikal ne kater breza. Bimësia në përqindje më të lartë është e përhapur në territorin kodrinor dhe malor. Ndër rrisqet që çënojnë florën veçojmë moszbatimin e kriterëve teknike gjatë procesit të grumbullimit të bimësive, kullotja dhe zjarret si dhe mungesa e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit. Kjo pasuri natyrore duhet vlerësuar dhe menaxhuar mbi baza tekniko-shkencore, pasi konsiderohet si vlerë e veçantë, prandaj shihet domosdoshmëria studimit dhe inventarizimit të bimëve mjekësore, eterovajore, e tanifere në shkallë bashkie. Lisi, ose dushku siç quhet në disa treva shqiptare, ka qenë një pemë shumë e përhapur që formonte formacione të mëdhej pyjorë, ashtu si dhe sot. Për banorët Prehistorikë kjo pemë në jetën e përditëshme të tyre përbënte gjithçka, ishte vetë jeta e tyre. Peizazhi është gjithçka që duket në territor mbi sipërfaqen e tokës dhe mund të studiohet në drejtimin estetik dhe dejtimin funksional që lidhet me shërbimet e ekosistemit. Të dyja këto drejtime janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe në fakt, aspekti funksional ndikon atë estetik. Zona të ndryshme të territorit, porë në shkallë peizazhi ata përbëjnë një të vetëm, duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda kufirit bashkiak. Në këtë larmishmëri peizazhistike dallohet fasha rurale, e cila karakterizohet nga toka bujqësore, toka të hapura të pozicionuara në mënyrë “informale”, grupime pemësh/shkurrësh, pemë të mbjella në rresht (vijë tampon) të cilat herë duken të mbjella nga njeriu e herë vetvetiu nga natyra, trupa ujorë (lumenj, kanale, rezervuare, etj.) dhe fasha natyrore, e cila është edhe fasha më e ndërlikuar në matricën peizazhistike. Kjo fashë karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, korridore të gjelbëra apo ujore, zona tampon, zona ripariene, zemra e habitatit, ngastra, si dhe mozaikë. Po në këtë fashë përfshihet edhe sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura natyrore brenda territorit të. Ndonëse një fashë komplekse dhe me diversitet të larmishëm biologjik, për shkak të zhvillimit njerëzor në tërësi dhe bujqësor në veçanti, fasha natyrore shfaqet e fragmentuar në tërësinë e vet. Tipologji tjetër peizazh-krijuese në është fasha/njolla urbane ku peizazhi shpaloset në zona banimi dhe shërbimesh me një karakter formal. Këtu peizazhi karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh zbukurorese, parqe si dhe zona tampon. Peizazhi industrial shfaqet i pandashëm nga fasha urbane, me përjashtim të pjesës jugperëndimore të territorit. Edhe ky peizazh ka karakter formal, ndonëse bimësia është më e rallë. Po ashtu, në krasitjen e paraqitjen e tyre i përkushtohet rëndësi zbukurimit, më tepër se sa funksionit dhe shërbimit mjedisor. Si në rastin e pemëve në peizazhin urban, edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi, apo publike. Ndikimet gjatë ndërtimit në biodiversitet, uje, toke dhe ajer do të jenë vendore dhe të përkohshme dhe te paperfillshme krahasuar me projektin madhor dhe teper interesant. Vendodhja e projektit eshte ne Prush. Tirana ndodhet 110 metra mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e fushës së Tiranës është 521 m, kurse dy malet më të larta rrëz të cilëve shtrihet janë Mali i Dajtit me 1612 m dhe Mali me Gropa me 1828 m. Qyteti gjendet rreth 34 kilometra larg detit Adriatik në perëndim. Nga jugu dhe perëndimi rrethohet nga kodra relativisht të ulta, kurse nga ana veriperëndimore Tirana shtrihet mbi një zonë të rrafshët. Në periferinë veriore kalon lumi i Tiranës. Disa kilometra më tutje nga ana jugore rrjedh lumi i Erzenit. Para reformës administrative të 2014, sipërfaqja e qytetit të Tiranës ishte rreth 31 km<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e gjithë rrethit ishte 1288 km<sup>2</sup> dhe përfshinte katër qendra: Tiranën, Vorën, Krrabën dhe Kamzën si dhe 150 fshatra. Pas reformës administrative bashkia e Tiranës u zgjerua në 1,110.03 km<sup>2</sup> ndërkohë që rrethet si njesi administrative u shkrinë. Tirana gjithashtu është pjesë e qarkut të Tiranës që ka një sipërfaqe prej 1,652 km<sup>2</sup> dhe përfshin pesë bashki : Tiranën, Kamzën, Vorën, Kavajën dhe Rrogozhinën.

**b) Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;**

Nga te dhenat e shpimeve te kryera ne sheshin e ndertimit rezulton se nuk kemi prezencen te ujrave nentokesore, por nuk perjashtohet mundesia ekzistenca ndonje burimi te vogel sezonal, ne kontakt me ndonji shtrese ranori qe ne taban kufizohet me shtrese argjiliti, ne kushte te tilla, nuk do te kemi prezencen e ujrave nentokesore, por nga projekti te merren masa per levizjen e disiplinuar te ujrave siperfaqesore, dhe ujrave sanitare, qe te mos shkarkohen ne zonen e rreshqitjes,per ndryshje shkaktone problem ne kohe per aktivizimin e saj.. 5-Shkaqet e lindjes se rreshqitjes.Shkaqet e lindjes se rreshqitjes me permasa rreth 70m ( perimetri ne koke te rreshqitjes)dhe diference kuatash ndermkjet kokes se rreshqitjes dhe pjeses fundore te saj jane reth 17.0m.Shkaqet jane te shumta duke filluar nga ato natyrore dhe ato te ndikimit njerzore.Nje nder faktore qe ndikon ne lindje e rreshqitjes eshte ,ndertimi gjeologo – litologjik dhe gjeomorfologjia 4 e relieve ,ku ne rastin konkret kemi te bejme me nje relief kodrinor mjaft I thyer , me pamje e nje lugine te thelle me shpate te thepisura , me pjerresi deri 600 ,te krijuar nga erozini i thellesis dhe reshqitje te pjeseshme dhe te vazhdushme , ne masa te vogela dhe shplarje nga ujrat rrjedhese siperfaqesore.Kjo rreshqitje eshte vjeter dhe ka ekzistur para ndertimit te shtepive dhe qe nuk ka ndikuar ne sheshin e ndertimit dhe ne objektet e ndertuara ,kjo vertetohet se ne te gjitha shtepit nuk verehet asnje ndikin fiziko gjeologjik negativ si carje apo cedime.por ne qoftese nuk merren masa inxhinerik ,kjo rreshqitje per nje kohe shume te shkurter mund te shkaktroj pasoja te renda duke demtuar objektet e banimit qe ndodhen prane themeleve te objekteve ne fjale.Nje nder shkaqet provokuaese i aktivizit te rreshqitjes ka ndikuar, veprimtaria e aktivitetit njerzor, duke hedhur mbeturina ndertim si dhe duke ndertuar mure betoni si masa mbrojtasi,por keto masa, jo vetem qe nuk kane ndikuar, pazitivish per stabilizimin e rreshqitje ,por kane ndikuar negativisht ,sepse themelet e murit mbajtes nuk eshte inkastruar ne formacionin baze ,por ne dherat eluviale shume te shkaterruar me pamje dherore,nen ndikimin e reshjeve atmosferike dhe ujrave sanitare ,keto dhera rreshqasin.Per mbrojtjen e shtepive te banimit dy dhe tre kate kerkohet te merren masa inxhinerike dhe si mase nevojshme eshte ndertimi i pilotave ,per gjate gjithe perimetrit te kokes se rreshqitjes .Ne sipërfaqen ku do te zhvillohet projekti dhe ne afersi te tij nuk gjenden burime ujore te cilat mund te preken nga projekti siperfaqja e zones eshte teresisht e thate. Kjo e ben dhe me te lehte proceduren e zhvillimit te projektit.

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike projekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk ka burime natyrale ujerash nentokesore dhe burime te perhereshme me perjashtim te reshjeve te ndryshme atmosferike. Duke gjykuar nga topografia e terenit, ndertimi gjeologjik i rajonit, topografia e zones se projektit dhe te dhenat hidrogjeologjike te mara nga punime te tjera te kryera ne teren per qellime te ndryshme, mund te themi se kushtet hidrogjeologjike jane te thjeshta. Dallohen kryesisht ujra te çarjeve, debiti i te cilave varet nga reshjet atmosferike dhe nuk perben ndonje problem te rendesishem per shfrytezimin e objektit. Ne brendesi te territorit nuk ka asnje burim uji . Vihet re fenomeni i karstit, me gropa te dimensioneve te ndryshme te cilat mbushen me uje gjete reshjeve. Nga pikpamja hidrografike, objekti nuk kufizohet me perrenj apo rrjedhje ujerash. Zona ku ushtrohet aktiviteti është në një distancë të tillë nga bregdeti që nuk ka të bëjë me ndikime direkte ose indirekte në hidrologjinë bregdetare dhe estaurinë pasi nuk ndikon në natyren e rrjedhjeve të ujrave. Ka vetëm shkarkime të ujrave sanitare në

“Rehabilitimi i Emergences Civile-Murbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”

grope septike. Vetem se zona ka nje gjeomorfologji sizmike dhe dhe te reshqitshme per kete arsye duhet te behet nderhyrje emergjente civile murbajtes me tel gabion.

**c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të**

**projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;**

*-Ndikimet negative ne karakteristikat fizike.* - Nuk do kete ndikime negative ne karakteristikat fizike te zones pasi kjo zone eshte nje zone e cila ka nevojte per kete nderhyrje emergjente pasi perben rezik per shtepite dhe banoret qe jetojne aty.

*-Ndikimet negative ne mjedis,biodiversitet, uje, toke, ajer*

*Ndikime minimale negative mund te kete te cilat prekin perkohesisht peizazhin ekzistues dhe topografine e saj per gjate kryerjes se aktivitetit . Me masat qe do merren per rehabilitimin e saj, gjelberimin me bime qe rriten ne zone, gjate projektit dhe ne mbyllje te aktivitetit , peizazhi dhe topografia e zones do te permiresohet dukshem do te krijohet nje ambjent i sigurt per banoret. Dëmtimi i vegjetacionit bimor, sidomos gjatë kryerjes se punimeve është faktor negativ. Zona qe do te zhvillohet nuk ka bimesi te larte eshte plotesisht e zhveshur dhe vende- vende rriten shkurre.Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar .Nga subjekti ne zbatim te projektit do te merren masa qe zona e projektit te jete gjithmone e kufizuar dhe te rehabilitohet. Zona ku do te zhvillohet projekti nuk përfaqëson zone me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundshme” për tu shpallur “Peizazh i mbrojtur”.*

**Ndikimet ne toke**

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka shkarkime ndotese ne toke, ne vendet e caktuara ne projekt parashikohet depozitimi i materialit te paperdorshem dhe perpunimi i tij me toke vegjetale per te mundesuar mbjelljen e bimeve dhe pemeve karakteristike te zones gjate fazes se rehabilitimit. Dherat e depozituara gjate ndertimit nuk permbajne elemente kimik ndotes per token, do te perpunohen me dhera te pasuruara me humuse, do te transportohen dhe shperndahen ne sheshet dhe do te pyllezohen me bime qe rriten ne zone per gjelberimin e saj. Gjithashtu mbetjet e krijuara nga veprimtaria humane e punonjesve ose nga proceset e punes do te trasportohen ne sheshin e depozitimit te miratuar nga pushteti vendor.

**Ndikimet ne uje**

Ndikimet ne uje do te jene minimaliste.Ne dite me rreshje nuk punohet. Ujerat e shiut do te sistemohen permes hapjes se kunetave dhe kanaleve per drenazhim dhe disiplinimin e ujerave te rreshjeve atmosferike.

**Ndikimet ne ajer**

Zhvillimi i projektit do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis gjate ndertimit, burime te tjera ndotese per ajrin nuk do te kete. Pajisjet qe do te perdoren per shfrytezimin dhe transportin e materialeve te ndertimit do te jene bashkohore dhe ne gjendje te mire teknike ne menyre qe te shmangen emetimet nga djegia e lendeve djegese qe ato perdorin. Meqenese nuk do te perdoren ne procesin e zhvillimit lende te

## “Rehabilitimi i Emergences Civile-Murbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”

demshme, nuk do te kete shkarkime te lendeve kimike te demshme per mjedisin ne ajer, toke dhe uje. Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis. Cdo veprimtari e re qe zhvillohet ne mjedis shoqerohet me pasoja dhe ndikime qe jane pjese e kompromisit qe shoqeria jone ka zgjedhur per t'u zhvilluar. Vleresimi i ndikimeve te mundshme ne mjedis si pasoje e zbatimit te projektit te propozuar eshte bere gjykuar mbi faktoret qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknikat e perdorura per ndertim, lendet e para te perdorura dhe mbetjet e gjenerura, te gjitha nen kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedis eshte analizuar sipas fazave te veprimtarise si me poshte: Cdo faze e zbatimit te projektit pervec ndikimeve te pergjithshme dhe te perbashketa ka edhe ato specifike qe varen nga faktoret qe i shkaktojne si p.sh. natyra e proceseve etj. Eshte e rendesishme te kuptohet natyra e ketyre proceseve dhe forma e shfaqjes se tyre, direkte dhe indirekte, per te vleresuar drejt ndikimet e cdo veprimtarie qe perdor burimet natyrore. Sipas natyres ndikimet klasifikohen ne dy grupe te medha:

- Ndikime te kthyeshme,
- Ndikime te pakthyeshme.

Te dy llojet e ndikimeve mund te minimizohen ne terma relative ku qellimi kryesor eshte mbajtja e ndikimit brenda siperfaqes se cdo objekti dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizim te proceseve komplekse te natyres dhe rigjenerim te biodiversitetit. Vete natyra e aktivitetit te propozuar dikton ndikime dhe efekte te perhershme ose ndikime mbetese ne karakterin e mjedisit te sapo krijuar pergjate gjithe teresise se tij, per zbutjen e te cilave propozohen masa konkrete.

### ç ) Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;

#### Ujera te ndotura

Me potenciale ne lidhje me ndotjen e ujrave nentokesore jane depozitimet/rrjedhjet e vajrave lubrikante dhe/ose karburanteve te makinave te renda gjate punimeve ose, me pas.Edhe ne rast te derdhjeve te pa vullnetshme (derdhje aksidentale) por edhe ndrrim i vajit ose rrjedhje te tij nga ana e makinerive te renda mund te ndotin ujrat nentoksore te cilat, sidomos te rrezikuara jane ato pjese te cilat ndodhen afer puseve te ujit. Subjekti ndertues do marr masa qe ti eliminoj sa me shume keto rrjedhje.

#### Gaze dhe pluhur

Nga ndertimi nuk mund te mungojne sasia e gazeve ndoshta minimale por pluhuri do jete i konsiderueshem gjate fazes se ndertimit. Kontraktori do kryeje cdo dite zbutje te sasise se pluhurit nepermjet sperkatjes se vazhdueshme me uje. Kontraktori do kete planin e tij te perditshem per minizimin e pluhurit.

#### Mbetjet

Gjate periudhes se ndertimit krijohen mbetje kryesisht inerte, dhera dhe mbeturinat e tjera etj. Kompania do lidhet me bashkine respektive qe te beje orientimet e duhura se ku duhen cuar mbetjet qe gjenerohen gjate ndertimit te projektit.



### **Zhurma dhe vibrime**

Zhurmat do të shkaktohen nga levizja e mjeteve të kryesisht nga përdorimet e mundshme të makinerive të renda që do të përdoren për proceset e që do të ndodhin apo procese të tjera ndertimore.

Kjo matrice është hartuar mbi bazën e seleksionimit të ndikimeve me të rëndësishme duke patur parasysh gjendjen e mjedisit përpara rifillimit të ndertimit dhe pas ndertimit të tij, ndikimet gjatë shfrytëzimit dhe gjendjen pas zbatimit të masave zbutëse/rehabilituese. Kurse vibrimet do të jenë shumë të pakta ose të papërfillshme.

### **d) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;**

Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar në këtë projekt. Çdo ndertim ka efekte pozitive dhe negative. E rëndësishme është që ndikimet negative të jenë të rikuperueshme dhe mos kenë pasoja të pakthyeshme në mjedis. Shtrirja hapësirë e ndikimeve negative nuk është aq e madhe sa të jetë shqetësuese pasi të mbarojë ndertimi do rehabilitohet që mjedisi të kthehet në gjendjen e mëparshme. Ndikimi në mjedisin e zonës do të ketë efektet e tij në një distancë jo shumë të gjatë, me dhjetra ose qindra metra, pra në një distancë jo më të largët se 50-100 m. Nuk shkarkohen elemente të demshme për mjedisin, si në atë ujor, për ajrin, tokën dhe për biodiversitetin. Ndikimi në peizazh do të jetë i perkohshëm për fazën e ndertimit ky impakt shtrin efektet e tij rreth zonës që do të ndertohet. Një element bazë i domosdoshëm për realizimin e projektit, është ekzistenca e një infrastrukture bazë urbane, duke filluar nga rrugët automobilistike, furnizimi me ujë, kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza, rrjetit të furnizimit me energji elektrike, rrjetit telefonik.

### **Ndikimet negative**

Gjatë punimeve të ndertimit do të ketë ndikime negative të konkretizuara:

1. Klirim i pluhurave në atmosferë, sidomos gjatë punimeve. Me vone gjatë punimeve të ndertimit, këto pluhura pakesohen.
  2. Nderkohe me pas, fillon edhe mbulimi për të evituar këtë fenomen. Gjatë punimeve do të krijohet një nivel i caktuar i zhurmave të cilat nuk do të jenë shqetësues për banorët dhe kalimtarët. Këto zhurma do të krijohen si rezultat i përdorimit të makinerive të ndryshme të ndertimit si vinca, betoniere, etj, për aq kohë sa do të përfundojë ndertimi (gjithsesi zhurma do të jenë e perkohëshme dhe në një kohë të caktuar kur njerëzit do të jenë të pranishëm që të mos shqetësohen banorët përreth).
  3. Do të kemi një shtim të trafikut të makinave në zonë, për shkak të ndertimit dhe me vone për shkak të rritjes së automjeteve për punë, të cilat do të rriten numerikisht në bazë të këtij ndertimi.
- Kohëzgjatja e ndikimeve negative do të jetë e perkohëshme dhe do të koncedojë me fillimin dhe mbarimin e punimeve në objekt. Pas marrjes së lejeve të nevojshme subjekti zhvillues do të transportojë lëndët e para për fillimin e punimeve. Sa më shpejt të merren lejet aq më heret fillojnë punimet dhe aq më shpejt mbarojnë dhe zona rehabilitohet duke sjellë përfundimin e ndikimeve negative.

### **dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësirë të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton**

“Rehabilitimi i Emergjences Civile-Murbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”

**distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;**

Çdo projekt ndertimor ka nje shtrirje hapesinore te ndikimeve negative ne mjedis ashtu sic ka dhe ndikime pozitive. Ndikimet negative jane vetem gjate fazes fillestare dhe zhvillimore te ndertimit.

**Ndikime pozitive**

Zbatimi i ketij projekti:

1. Do te punesohen persona qe do merren me ndertimin.
2. Pas perfundimit te punimeve dhe te fillimit te funksionimit te nderteses: ujrat e bardha e te zeza, nuk do te paraqesin problem mjedisor, pasi ato do te bashkohen me magjistralin e tubacioneve te zones.
3. Ky projekt, nuk do te shkaktoje ndotje te rende ne mjedis.
4. Zona do te mbahet me po ato funksione.
5. Per shkak te rreshkitjes jetesa e banoreve eshte ne rrezik me kryerjen e ketij projekti do evitohet rreziku.
6. Nuk do te kete ndotje te ujrave nentokesore sepse te gjitha ujrat e zeza qe do te dalin, do te shkarkohen ne kolektorin e ujrave te zeza te zones dhe prej kesaj ne tubacionin kryesor qe pershkon kete zone.
7. Nuk do te krijohen ndotje te ajrit, duke qene se, si gjate fazes pergatitore punimeve ndertuese, ashtu edhe pas perfundimit te tyre, ne zone nuk do te zhvillohet asnje aktivitet industrial (perjashto trafikun e makinave) qe te kete ndikim ne mjedis.
8. Permiresimi i anes estetike, duke plotesuar pamjen urbanistike.

**Masa qe do merren per zbutjen e ndikimeve**

Ndertuesi gjate fazes ndertuese, eshte i obliguar te zbatoje te gjitha masat kunder zhurmes, ne pershtatje me direktivat e BE. Masat qe duhen aplikuar konsistojne si me poshte:

Ne zonat e banuara punimet nderpriten gjate nates.

Mjetet gerrmuese dhe ato transportuese do te perdorin detyrimisht silenciatore.

Kompresoret duhet te pershtaten sipas modeleve perkatese me kapaket e radhitur dhe te mbyllur mire te cilet do te mbahen mbyllur per sa kohe qe makinerite jane ne pune dhe te gjitha mjetet e tjera shtese pneumatike qe do te pershtaten me silenciatoret perkatese. Makinerite qe do kene shfrytezim te here pas hershem do te mbyllen here pas here ne kohen kur nuk do te nevojitet per shfrytezim.

**Menaxhimi i marrredhenieve me punetoret**

Kontraktuesi do të mbajë politika të burimeve njerëzore të përshtatshme për madhësinë dhe forcën e punës që përcakton qasjen e saj drejt menaxhimit të fuqisë punëtore në përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar. Këto politika do të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të arritshme për punëtorët:

- Krijimi dhe mbajtja e marrëdhënieve të shëndetshme ndërmjet punonjësit / menaxhmentit
- Promovimi i trajtimit të drejtë, mosdiskriminimit dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punonjësit
- Ligjet e punës dhe punësimit në vend, si dhe parimet kryesore dhe standardet rregullatore të përcaktuara në Kodin e Procedurës së Republikës së Shqipërisë

## “Rehabilitimi i Emergjences Civile-Murmbajtes me tel gabion, Rruga “Kol Kamsi”

- Të mbrojnë dhe promovojë shëndetin e punëtorëve, duke promovuar në veçanti kushte më të shëndetshme dhe më të sigurta të punës

### **Marredheniet e punes**

Kontraktuesi do të dokumentojë dhe komunikojë me të gjithë punëtorët kushtet e punës dhe kushtet e punësimit duke përfshirë të drejtën e tyre për paga, orët e punës, rregullimet jashtë orarit dhe kompensimin jashtë orarit, si dhe çdo përfitim (si pushimi për sëmundje, lindje / atësi ose pushim).

### **Mosdiskriminimi dhe mundësia e barabartë**

Në veçanti, kontraktuesi nuk do të marrë vendime për punësim në bazë të karakteristikave personale, kërkesat e punës bazojnë marrëdhënien e punës në parimin e mundësive të barabarta dhe trajtimit të drejtë dhe nuk do të diskriminojnë në lidhje me të gjitha aspektet e marrëdhënies së punës, duke përfshirë rekrutimin dhe punësimin, kompensimin (duke përfshirë pagat dhe përfitimet), kushtet e punës dhe kushtet e punësimit, qasja në trajnim, promovimi, ndërprerja e punësimit ose dalja në pension dhe disiplina.

### **Pagat, përfitimet dhe kushtet e punës**

Pagat, përfitimet dhe kushtet e punës së ofruar duhet të jenë përgjithësisht të krahasueshme me ato të ofruara nga punëdhënësit ekuivalentë në rajonin përkatës të atij vendi / rajoni dhe sektori në fjalë.

